

*Oda e Mjekëve e Maqedonisë*



**RREGULLORE**

**për vlerën e kostove për lëshimin, vazhdimin dhe ripërtëritjen e licencës së punës**

**Shkurt, 2017**

Në bazë të nenit 136, paragrafi (3) të Ligjit të Mbrojtjes Shëndetësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15 dhe 192/15 dhe 17/2016) të nenit 14, nga Statuti i Odës së Mjekëve të Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 24/95, 30/95, 22/96 dhe 36/00), Kuvendi i Odës së Mjekëve të Maqedonisë në seancën e mbajtur më 10.11.2016, 17.11.2016 dhe 23.2.2017, miratoi

## **RREGULLORE**

**për vlerën e kostove të lëshimit, vazhimit dhe ripërtëritjen e licencës së punës**

### **Neni 1**

Me këtë Rregullore përshkruhet vlera e shpenzimeve për dhënien, vazhdimin dhe ripërtëritjen e licencës së punës për punonjësit shëndetësorë me arsim të lartë në fushën e mjekësisë (në tekstin e mëtejme: doktor i mjekësisë).

### **Neni 2**

Shpenzimet për dhënien, ripërtëritjen dhe vazhdimin e licencës për punë të doktorëve të mjekësisë përcaktohen në varësi të kostove reale administrative të cilat përbëhen nga shpenzimet për punën e anëtarëve të trupave punues, personelit administrativ të Odës dhe punonjësve të punësuar si bashkëpunëtorë të jashtëm dhe shpenzimet materiale për furnizimin e letrës, formularëve dhe materialeve të tjera të zyrës, shtypjen dhe prodhimin e licencës për:

1. Shpenzimet për dhënien e licencës për punë si doktor i mjekësisë për mbrojtjen primare shëndetësore, licencën e përkohshme si specializant i vjetër dhe licencën specialist/subspecialist e kompenson në masë që paguhet një herë dhe shuma e saj është **1.500, 00 denarë.**

2. Shpenzimet për lëshimin e licencës së doktorit të mjekësisë shtetasit të huaj e kompenson në një shumë që paguhet një herë, si më poshtë:

- për vitin e parë **60.000,00 denarë**

- vazhdim për çdo vit pasues **30.000,00 denarë**

3. Shpenzimet për vazhdimin e licencës së doktorit të mjekësisë e kompenson në shumë që paguhet një herë dhe shuma e saj është **2.600,00 denarë.**

4. Shpenzimet për ripërtëritjen e licencës për punë të doktorëve të mjekësisë e kompenson në shumë që paguhet një herë në shtatë vjet dhe shuma e saj është **840,00 denarë.**

5. Shpenzimet për ndërrimin e formularit të licencës në rast të dëmtimit ose humbjes e kompenson në shumën që paguhet një herë dhe shuma e saj është **600,00 denarë.**

### Neni 3

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, nuk vlen më Rregullorja për mënyrën e përcaktimit të shpenzimeve për kryerjen e procedurave për lëshimin, vazhdimin dhe ripërtëritjen e licencave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 69/9)

### Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, a do të publikohet pas pëlqimit të Ministrit të Shëndetësisë.

Nr.02 - 3969/11

1.3.2017

Kryetari i

Odës së Mjekëve të Maqedonisë

Prof. Dr. Koço Çakalaroski